

Data 16.09.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Ndërhyrje për përmiresimin e shtresave asfaltike, Rajoni 1 dhe 2 (Faza IV).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,249,999,999.89 Lekë pa TVSH.

Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore GOA për periudhën 2024-2026. Kodi Output: 23AB403.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës në procedurën e prokurimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

NP-1 B: Punime gjermimi në tokë

NP-4 G: Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

NP-5 B: Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP-12 A: Punime të inxhinierisë së mjedisit

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

NS-1 A: Punime për prishjen e ndërtimeve

NS-18 A: Punime Topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 B	Punime gjurmimi në tokë	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu me eskavator goma 0.25m³ ne kanale gjeresi >2 m kat III me shk ne mjet. - Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet. - Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir . 	21-50 mln leke	35'816'825.68 leke
NP-4 G	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	<ul style="list-style-type: none"> - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm. - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese stabilizant t=10cm. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri 	Mbi 800 mln leke	1'138'602'666.64 Leke

		<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me makineri (per profilim) - Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri - Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.) - Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri (per bankina) 		
NP-5 B	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	<ul style="list-style-type: none"> - Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.) - Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri (per bankina) - F.V Tub metalik per tombino (me diameter dhe spesor te ndryshem sipas rastit) - Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni 	21-50 mln leke	37'214'646.29 Leke
NP-12 A	Punime të inxhinierisë se mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> - Transport dheu me auto deri 5.0 km 	0-20 mln leke	19'594'189.93 leke

NS-1 A	Punime per prishjen e ndërtimeve	- Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm.	0-20 mln leke	18'916'925.81 leke
N.S-18. A	Punime topogjeodezike.	- Rilevim Topografik, piketime ne referim te raportit dhe specifikimeve teknike		0-20 mln leke

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 4 (katër) Inxhinier Ndërtimi
- 4 (katër) Inxhinier Hidroteknik
- 4 (katër) Inxhinier Gjeodet
- 2 (dy) Inxhinier Mjedisi
- 2 (dy) Inxhinier Mekanik
- 4 (kater) Ekspert i sigurisë dhe shëndetit

Për të dëshmuar përbushjen e kriterit 1.1.2 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Personelin kryesor nuk duhet te jete i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specififikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin e objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

Inxhinier Ndërtimi	Inxhinieri i ndërtimit nevojitet për organizimin e kantierit të ndërtimit, për ndjekjen në tërësi të punimeve dhe bën koordinim e të gjithë personelit teknik në objekt për mbarëvajtjen e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe grafikut të parashikuar në kontratë. (Referuar zërave të punimeve të preventivit)
Inxhinier Hidroteknik	Inxhinieri hidroteknik nevojitet për ndjekjen e punimeve të kullimit të ujërave, tombinove; (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mekanik	Inxhinieri mekanik nevojitet për ndjekjen e instalimeve të depozitave qendrore (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Gjeodet	Inxhinieri gjeodet nevojitet për piketimin fillestar të objektit dhe piketimin në vazhdimësi të të gjithë punimeve sipas proceseve të punës. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mjedisi	Inxhinieri i mjedisit nevojitet për ndjekjen e punimeve të gjurmimit me qëllim ruajtjen e gjelbërimit, ruajtjen e ambientit gjatë kryerjes së punimeve; përcaktimin/selektimin e pikës së depozitimit të hedhurinave dhe materialeve të dalta nga gjurmimi. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Ekspert i sigurisë dhe shëndetit	Ekspert i sigurisë dhe shëndetit nevojitet për të kontrolluar dhe minimizuar rreziqet që mund të ndodhin gjatë punës në kantier.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në

rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatës lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” rekomandohet të jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 135 persona** për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave, e vertetuar kjo me:

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve projektuesi ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muaj, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore

të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosija e kriterit për një punësim të paktën 135 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim). Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Total orë pune (Specialist + Punëtor+manovrator=kamionist)= 235*420 orë (sipas zëbrthimit të analizave)

Ore/1 ditë pune= 8 ore

Total Ditë pune punëtori= 235*420 orë/8 orë= 29*427 ditë pune

Dite pune gjithsej= 24 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 22 ditë/muaj= 528 ditë pune Numri i fuqisë punëtore = 29*427 dite pune /528 ditë ≈ 56 punëtore

Total orë pune (Manovrator)= 60*769 orë (sipas zëbrthimit të analizave)

Sqarim: Për shkak të arsyeve të mëposhtme fuqia punëtore duhet të jetë më e lartë sesa ajo e llogaritur:

1- Zona ku do të zhvillohet projekti është relativisht e gjere dhe për këtë janë parashikuar 4 kantiere ndërtimi.

2- Kohëzgjatja e punimeve është dy vjet. Gjatë kësaj periudhe nuk përjashtohen ditët me mot të lagësht dhe me temperatura të ulëta, gjatë të cilave disa procese pune të rëndësishme nuk mund të realizohen (asfaltimi dhe betonimi kërkojnë temperatura mbi 5°C dhe mot të thate)

3- Ecuria e proceseve të punës nuk mund të jetë asnjëherë uniforme, d.m.th. mund të ketë ditë kur të nevojiten një numër më i madh punëtorësh në varësi të procesit të punës.

Për shkak të arsyeve të mësipërme dhe bazuar në eksperiencën e punimeve të ngjashme është pranuar që numri i fuqisë punëtore të jetë jo më i vogël se **135 persona**.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme.

Nr.	Mjeti	Sasia (copë)	Statusi
1	Eskavator me zinxhire	8	në pronësi ose me qera
2	Eskavator me goma	2	në pronësi ose me qera
3	Fadrome me goma	2	në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhirë i pajisur me çekiq	2	në pronësi ose me qera
5	Minieskavatore 2 deri 9 ton	8	në pronësi ose me qera
6	Bob Cat	2	në pronësi ose me qera

7	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	10	në pronësi ose me qera
8	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	10	në pronësi ose me qera
9	Kamionçine me kapacitet mbajtës deri 2 ton	4	në pronësi ose me qera
10	Kamion i pajisur me vinç	2	në pronësi ose me qera
11	Impiant prodhim asfalti i pajisur me leje mjedisi	1	në pronësi ose me qera
12	Asfaltoshtruese	4	në pronësi ose me qera
13	Rrul asfalti Gome-Cilinder 2 – 6 ton	4	në pronësi ose me qera
14	Rrul asfalti Cilinder-Cilinder 4 – 6 ton	4	në pronësi ose me qera
15	Rrul asfalti Gome-Gome mbi 8 ton	4	në pronësi ose me qera
16	Sharre/prerese asfalti	4	në pronësi ose me qera
17	Freze asfalti mbi 18 ton	1	në pronësi ose me qera
18	Freze asfalti	2	në pronësi ose me qera
19	Fshese asfalti	4	në pronësi ose me qera
20	Fshese asfalti me aspirim	1	në pronësi ose me qera
21	Nyje per prodhim inert i pajisur me leje mjedisi	1	në pronësi ose me qera
22	Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 18 ton	2	në pronësi ose me qera
23	Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 10 ton	2	në pronësi ose me qera
24	Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	2	në pronësi ose me qera
25	Grejder	4	në pronësi ose me qera
26	Autobot uji	4	në pronësi ose me qera
27	Betoniere kantieri 500 liter	4	në pronësi ose me qera
28	Semafore sinjalistike per punime rrugore	4	në pronësi ose me qera
29	Tabela sinjalistike provizore (sigurimin teknik)	120	në pronësi ose me qera
30	Zyre kantieri e levizshme (mobile)	4	në pronësi ose me qera
31	Kompresor	4	në pronësi ose me qera
32	Gjenerator	4	në pronësi ose me qera
33	Vibrator betoni	8	në pronësi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrata. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Argumentimi i mjeteve është si mëposhtë:

Mjetet	Sasia (copë)	Proceset e punës
--------	--------------	------------------

Ekskavator me zinxhir	8 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu me eskavator goma 0.25m³ ne kanale gjeresi >2 m kat III me shk ne mjet. - Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet. -
Ekskavator me goma	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu me eskavator goma 0.25m³ ne kanale gjeresi >2 m kat III me shk ne mjet. - Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet.
Eskavator me zinxhirëi pajisur me çekiq	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Germim shkemb mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir
Fadrome me Goma	2 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.
Miniekskavatore deri ne 9 Ton	8 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu me eskavator goma 0.25m³ ne kanale gjeresi >2 m kat III me shk ne mjet.
BobCat	2 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobeton me granil guri kave, 4cm, me makineri
Kamione vetshkarkues mbi 20 Ton	10 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Transport dheu me auto deri 5.0 km - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobeton me granil guri kave, 4cm, me makineri.
Kamione vetshkarkues mbi 30 Ton	10 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Transport dheu me auto deri 5.0 km - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobeton me granil guri kave, 4cm, me makineri
Kamioncine me kapacitet deri ne 2 Ton	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - F.V Tub metalik per tombino (me diameter dhe spesor te ndryshem sipas rastit) -
Kamion i Pajisur me Vinc	2 copë	<ul style="list-style-type: none"> - F.V Tub metalik per tombino (me diameter dhe spesor te ndryshem sipas rastit) - Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni.
Impiant prodhimi Asfalti i pajisur me leje Mjedisi.	1 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri
		<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me makineri

		<p>(per profilim)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri
Asfaltoshtruese	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me makineri (per profilim) - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri
Rrul asfalti Gome-Cilinder 2 – 6 ton	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri -
Rrul asfalti Cilinder-Cilinder 4 – 6 ton	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me zall lavatrice, 3cm, me makineri (per profilim) - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri
Rrul asfalti Gome-Gome mbi 8 ton	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri
Sharre/prerese asfalti	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri.
		<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri

Freze asfalti mbi 18 ton	1 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri me thellesi deri ne 20cm
Freze asfalti	2 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm.
Fshese asfalti	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm.
Fshese asfalti me aspirim	1 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Skarifikim shtrese asfalti me makineri h=10cm. - Frezim shtrese asfalti me makineri h=1-3cm.
Nyje per prodhime inerti e pajisur me leje mjedisore	1 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	2 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri (per bankina)
		<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.

Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 10 ton	2 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 18 ton	2 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri. - Shtrese asfalti mikse (binder+asfaltobeton) me zall lavatrice, 6cm, me makineri. - Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
Greider	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.
Autobot Uji	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. - Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.
Betoniere kantieri 500 liter	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.)
Semafore sinjalistike per punime rrugore	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Per organizmin dhe mbarevajtjen e proceseve te punes, rritjen e sigurise dhe shendetit ne pune gjate ekzekutimit te punimeve.
Tabela sinjalistike provizore (sigurimin teknik)	120 cope	<ul style="list-style-type: none"> - Per organizmin dhe mbarevajtjen e proceseve te punes, rritjen e sigurise dhe shendetit ne pune gjate ekzekutimit te punimeve.
Zyre kantieri e levizshme (mobile)	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Per organizmin dhe mbarevajtjen e proceseve te punes.
Kompresor	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Struktura monolite betoni C 20/25 (per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta portale etj.)
Gjenerator	4 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.)
Vibrator betoni	8 copë	<ul style="list-style-type: none"> - Struktura monolite betoni C 20/25.(per kuneta, bordura, kanale, mure, puseta potrale etj.)

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

-Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurrohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | | |
|---|-------|----|
| 1. Çmimi | pikët | 65 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | pikët | 15 |
| 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) | pikët | 10 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) | pikët | 5 |

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) pikët 5
(jo më pak se 3 %)

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi [0 - 65] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë [0 -15 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këtë kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

Punime të ngjashme për:

- Punime shtesë asfaltbetoni me sipërfaqe jo më pak se 283,777 m² për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjecare, gjatë pesë viteve të fundit 15 pikë

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjecar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 muajore të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit.

Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë "0" pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k2}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)
$P_{\max k2}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qënë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

- **Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet.**
- **Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet.**
- **Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:**

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

Shënim: Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve ne vite e ofruar nga OE, do te jete pjese e kushteve te kontrates e percaktuar ne Shtojcën 16 e dokumenteve të tenderit, Neni 10, pika 10.4.

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) [0 - 5 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubrikën specifike/zerin “Siguria në kantiere (Planin I Sigurisë e Kordinimit në Kantiere PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023”, në preventivin e ofertës:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantiere, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantiere, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantiere (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të veçantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e veçantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrikë në masën jo më pak se 3%, përllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se 37,500,000 leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantiere, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantiere”, Aneksi VI “Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantiere të perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantiere/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zerin Siguria në kantiere (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantiere PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera. 37,500,000 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera. 37,500,000 leke pa tvsh do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantiere më të lartë se vlera 37,500,000 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} \times P_{\max k5} / V_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria në kantiere/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendet, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendet, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shume se dyfishi i** mesatares së ofertave të vlefshme.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendet impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

$$\begin{aligned} O & \quad - \text{(pikët e Ofertës)} \\ Mo & \quad - \text{Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme} \\ N & \quad - \text{Numri i ofertave të vlefshme} \\ PR \text{ (Rrm)} & \quad - \text{Rritje e mundshme} \\ Mo & \quad = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N \\ PR & \quad = 200 \% Mo \end{aligned}$$

Vlera e ofertave të ofruara $> PR$ rjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendet impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ($200\% MO = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve jane pjese e pandare e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

